




Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

Nr. 12-060-551 dt. 19.09, 2019



Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
26.07.2019

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 26.07.2019

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 28 anëtarë

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 27.06.2019.
2. Propozim vendim për ridestnim dhe transfer të mjeteve nga kategoria e projekteve kapitale dhe kategoria për mallra dhe shërbime në shpenzime kapitale.
3. Propozim vendim për ridesnim të mjeteve nga Drejtorati për infrastrukturë Publike.
4. Propozim vendim për formimin e Panelit përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Barazi Gjinore.
5. Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësim/ndryshimin e Rregullores për subvencione të Komunës së Drenasit.
6. Raporti financiar i zhvillimit të buxhetit Janar - Qershor 2019.
7. Plani i Veprimit për Implementimin e Rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
8. Propozim Vendimin për Financimin e Projektit HANDIKOS-Drenas.
9. Të ndryshme.

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 26/07/2019 ishin: Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, përfaqësues të OSCE-së, përfaqësues të KDI-së, përfaqësues të KFOR-it si dhe drejtor të Drejtorive përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- pasi përshëndeti të gjithë, hapi diskutimin për rendin e ditës dhe njoftoi anëtarët e Kuvendit Komunal se kemi edhe një pikë shtesë në rendin e ditës: propozim vendim për themelimin e komisionit komunal të aksionareve të NPL – Stacioni i Autobusëve SH.A Glllogoc, kërkoj nga anëtarët e kuvendit se a pajtohen me këtë rend dite, apo ka ndonjë propozim?

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime Kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës me një pikë shtesë

Për votuan 28 anëtar,

Kundër votuan 00 anëtar

Abstenim 00 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:
1.Procesverbal i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 27.06.2019.

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar:

Për votuan 27 anëtar,

Kundër votuan 00 anëtar ,

Abstenim 00 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:
2.Propozim vendim për ridestitim dhe transfer të mjeteve nga kategoria e projekteve kapitale dhe kategoria për mallra dhe shërbime në shpenzime kapitale.

Vehbi Berisha- pati një pyetje: tek faqja e dytë tek shpenzime kapitale nuk e kam të qartë, se këtu paskan tregu për secilin mbetje tek secili projekt, por këtu tek kodi i projektit bashkëfinancim të projektit me shumë prej 8,359 € nuk e kuptova për çka bëhet fjalë, nuk e paskeni cek projektin për çka bëhet fjalë ndërsa të tjerat po.

Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjencë Lumnije Krapit- në këtë propozim vendim kemi ridestitim të projekteve kapitale nga kategoria mallra dhe shërbime dhe transfer, janë mbetje nga të gjitha projektet mirëpo kur kemi mendu me i redistinu këto mjete është kodi bashkëfinancim pa marrë parasysh a është me ministri apo me organizata të huaja, vetëm e kemi emëruar si kod i kemi të caktuara 3,000 € mirëpo po na duhet edhe këto mjete me i bartë më i vendos këtë kod

Sokol Bylykbashi- sa i përket kësaj pike edhe unë dua të ndalem këtu për shkak të mos specifikimit për çka do të shpenzohen këto mjete me vlerë 8,359 €, drejtoreshën nuk e dëgjova që dha ndonjë sqarim vetëm tha që është kod dhe dojm me shtu edhe këtë shumë, mirëpo është

mirë kur ne dojmë më votu me ditë saktë edhe në qoftë se janë edhe 50 €, me ditë ku po shkojnë ato mjete, është mirë me qenë e specifikuar në letër saktë. Ndërsa trajtimi i qeneve endacak nëse është mbetje pse kanë mbet këto mjete?

Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjencë Lumnije Krapit- tek trajtimi i qeneve endacak, mallra dhe shërbime ka qenë kontratë kornizë tri vjeçare nuk e kemi të parapare, mirëpo meqenëse projekti është i paraparë të zhvillohet nga niveli qendror atëherë dy projekte për të njëjtin qëllim nuk mundemi me i procedu me tutje, ndërsa sa i përket kodit me bashkëfinancim është edhe arsyetimi janë mjetet e parapamë me Giz-in, konkretisht për menaxhimin e mbeturinave.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- këto mjete në bashkëfinancim i përcaktojmë që kur kemi mundësi me marrë një donacion nga dikush mjete nga organizata të huaja e kemi kodin e hapur dhe hymë menjëherë në veprim sepse pa e pas një kod siç është rasti me Giz-in se kur kemi një kod për bashkëpunim me OJQ-të nuk mundemi me vazhdu projektin kështu që këto mjete po i ndajmë për atë çështje, ndërsa çështja e mjeteve të mbetura për qentë endacak është programi qeveritar i cili i ka ndarë mjetet për AVUK-in dhe ne e kemi pas këtë buxhet të miratuar dhe nuk kemi mundur me ndërhy, tash ato mjete i bartim diku tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

Për votuan 26 anëtar,

Kundër 00 anëtar,

Abstenim 00 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:
3.Propozim vendim për ridesnim të mjeteve nga Drejtorati për infrastrukturë Publike.

Sokol Bylykbashi- është e qartë pra që janë mbetje nga investimet kapitale shuma e përgjithshme 30,000 € sa i përket vendit se ku do të shkojnë këto mjete thuhet që asfaltimi i rrugës në Terstenik I-II mirëpo vërejtjen e kam se nuk po cekni lagje nuk po mundemi me ditë, edhe kur e kemi miratuar buxhetin për këtë vit lista e investimeve kapitale ka qenë shumë e paqartë nuk janë ndarë as fshatrat ose kanë hy tri-katër fshatra në një kod, dhe nuk janë përmend as lagjet, dhe ne nuk mundemi me iu dhënë sqarim edhe qytetareve se çka do të bëhet në fshat timin unë nuk kam ditë me i tregu për shkak se i keni futur në një kod tri-katër fshatra dhe nuk e dija se ku shkojnë ato mjete, është mirë me ditë saktë se në cilën lagje po shkojnë mjetet.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, e kemi votu buxhetin për me mujt me i shfrytezu sa ma mirë mjetet të cilat i ndanë kuvendi, ne kur ta bëjmë buxhetin për vitin e ardhshëm kemi me u mundu mos më lënë më me fshatra, por kemi me thënë rrugë të asfaltuara në Komunën e Drenasit, Kanalizim në Komunën e Drenasit, ujësjellës për shkak se mjetet mos me shku suficit po me mundur me i shpenzu, në fshatin Terstenik nuk ka me mbet me asnjë lagje pa asfaltu.

Petrit Sinani-të nderuar, u diskutua e tera se çka patëm me diskutu mirëpo kush e ka votu buxhetin herën e kaluar i kemi pas vërejtjet e njëjta po thuajse me Sokolin për shkak se nuk po përfshihen me emra, mirëpo tani mesa dëgjova kryetarin ne do ta votojmë buxhetin komplet me asfaltim të rrugëve dhe gjë e cila lehtëson procedurat si ne prokurim si të gjitha, mirëpo unë kisha dashtë kur ta përfundojmë votimin do të ishte mirë që me pas edhe një nen ku ne si asamblist me bë kërkesa të ndryshme kujt i intereson cila rrugë është ndërtuar edhe kodin, është mirë me i specifiku ma sakt.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci-do të bëhet ajo mirëpo nuk do të thotë që nuk kemi me ditë se ku do t'i qojmë sepse infrastruktura do t'i masë rrugët dhe do të specifikon se sa rrugë në Komunën e Drenasi do të shtrohen me asfalt por me një kod për mos me met mjetet për mos me humb kohë do t'i fusim më një kod.

Perparim Shala-edhe unë nuk jam i pajtimit me këtë ridestitim të mjeteve që po bëhet dhe forma si po bëhet, është mirë fillimisht me i shiku ato fshatra që po i tërhiqni këto mjete a kanë probleme tjera. Do të ishte mirë se ato mjete të cilat teprojnë në një fshat është mirë me shiku në atë fshat a ka nevojë apo probleme tjera.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- projekti apo mbetjet që mbesin nuk kemi të drejtë me i nda ato mjete prapë në atë fshat sepse nuk është votu buxhet për atë projekt. Ligji nuk na lejon me paraparë ashtu.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- pasi nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

Për votuan 25 anëtar

Kundër 01 anëtar

Abstenim 00 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës:
4.Propozim vendim për formimin e Panelit përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Barazi Gjinore.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, nga ekzekutivi propozoi:

Gentianë Morina- anëtare nga ekzekutivi

Kajtaž Kastrati-anëtar nga ekzekutivi

Mahije Ismaili- anëtare nga shoqëria civile.

Gani Podrimqaku- propozoi:

Florentina Kukaj-anëtare nga kuvendi,

Vehbi Berisha-Propozoi

Fitore Morina –anëtare nga kuvendi,

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës me atë perberje të komisionit:

Për votuan 25 anëtar,

Kundër 00 anëtar,

Abstenim 00 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:
5.Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësim/ndryshimin e Rregullores për subvencione të Komunës së Drenasit.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- tek propozimi i ri është Arigon Sinani.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- propozoi nga ekzekutivi:

Agim Kastrati- anëtar nga ekzekutivi

Lumturie Kiqina-anëtare nga ekzekutivi

Gentrit Mulaku – nga shoqëria civile

Gani Podrimqaku- propozoi

Petrît Sinani-anëtar nga kuvendi

Sabrije Kukaj-propozoi

Burim Bujupi- anëtar nga kuvendi

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

Për votuan 26 anëtar,

Kundër 00 anëtar,

Abstenim 00 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:
6.Raporti financiar i zhvillimit të buxhetit Janar - Qershor 2019.

Florentina Elezi- sa i përket raportit financiar për gjashtë mujorin e parë unë kam vërejtje tek Drejtoria e Infrastrukturës se e ka një përqindje të realizimit të buxhetit shumë të ulët.

Vehbi Berisha- sa i përket buxhetit tek realizimi i të hyrave vetanake të muaji qershor a është kjo kur i patëm inkasu disa mjete nga Parku i Biznesit që na ka ndryshu përqindjen?

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:
7. Plani i Veprimit për Implementimin e Rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Sokol Bylykbashi- ne e dimë që pasqyrat financiare dhe punët në komunë monitorohen nga auditori i përgjithshëm dhe nga auditori i brendshëm, këtë të fundit nuk e dimë punën, sepse kurrë nuk na kanë sjellë ndonjë informatë dhe është mirë me na sjellë, është ndihmese e

organeve të komunës dhe ne jemi organi më i lartë, le të na sjellin edhe ata raportet sikurse zyra e auditorit të përgjithshëm, në bazë të asaj çka kom shiku raportin kam parë që Komuna Drenasit ka mangësi, ka dobësi, ka probleme ka edhe shkelje edhe problemi tjetër se çka kam vërejtur në atë raport është që kryetari shumë pak i ka përmbushë rekomandimet dhe kjo është shqetësuese, nëse nuk zbatohen rekomandimet e auditorit që bëhet nga ekspert kjo i bie që problemet në komunën e Drenasit kanë me pas jetë më të gjatë, vetëm zbatimi i tyre dhe përpjekja me i zbatu i eliminon ato probleme. Mua më vjen mirë që kryetari i ka bërë një plan, që ato probleme me i trajtu në mënyra profesionale dhe mos me qenë me pjesë e raportit të ardhshëm e auditorit të përgjithshëm, unë uroj që ky plan do të zbatohet dhe do ta votojmë se është një plan pozitiv.

Beqir Kiqina- sa i përket kësaj pike janë disa çështje që dua t'i ngriti në këtë seancë ne si AAK, dhe mendoj se edhe Komuna Drenasit në vijim edhe në vitet e ardhshme duhet të veproj edhe sipas të gjeturave të auditorit dhe duhet t'i përmbush kërkesat e zyrës së auditivit. Opozita në Drenas shumë herë ka përmend çështje të cilat i kanë preokupuar edhe qytetarët por e kanë preokupuar edhe qeverisjen dhe janë bërë shumë gabime dhe me kohë duhet të mënjanoen. Në raportin e auditimit ka shumë gjera të cilat opozita i ka përmend edhe me herët psh. ne seancat e kaluara e kam ngrit çështjen për gabimet tek pagat dhe mëditje pagat jubilarë dhe pagat sipas marrëveshjes kolektive, gabimet që janë bërë kur janë pagu këto paga janë marrë prej investimeve kapitale në vlerë prej 37 mijë e me shumë euro, dhe këto e ka tërheq vërejtjen edhe zyra e auditimit, por këto nuk janë të vetmet, punësimet gjithashtu janë përmend rregullisht që janë një preokupim për Komunën e Drenasit, psh në raportin e auditimit kemi gabime në rekrutimin e nëpunësve si psh. Në sektorin e bujqësisë, po ashtu edhe keqklasifikimin në shpenzimet e kategori dhe kode ekonomike psh. Për kodet ekonomike dhe shpenzimet raporti i auditimit i cek si të keq menaxhuara, shpenzimet për mallra dhe shërbime psh. Shërbimet për mallra dhe shërbime që janë bërë nga Komuna e Drenasit në bashkëpunim edhe me organizatat tjera ka gjetje edhe në raportin e auditimit që janë të keq menaxhuara, ka shumë probleme, Komuna e Drenasit ka një ngritje sa i përket performances por mendoj që me një bashkëpunim pozitiv dhe opozitiv dhe rekomandimet tona që mundemi me i dhënë mendoj se sa ma shumë me ngrit efikasitetin dhe komuna me qenë me e përgjegjshme në këto çështje.

Sabrije Kukaj- sqaroj që nuk ka faj komuna për pagat jubilarë dhe për zëvendësim të lehonave, për pagat jubilarë nuk ka pas mjete shtesë për këtë arsye janë marrë me përmbarues prej mallra dhe shërbime, nuk është faj këtu komuna për pagesa.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- jemi duke i shqyrtuar të gjitha mundësit për me fillu këtë procedurë.

Vehbi Berisha- u fol shumë për pagat jubilarë dhe pagave sipas marrëveshjes kolektive, është e vërtetë që kjo çështje nuk është problem vetëm i joni mesa kam shiku të gjitha komunat e kanë këtë problem. Më bëri përshtypje plani i implementimit të këtyre rekomandimeve të auditorit kur ka thënë tek kjo rekomandimi B-2 tek keqklasifikimi i shpenzimeve kategori dhe kode ekonomike auditori ka thënë që nuk e keni klasifikuar siç duhet kodin dhe shpenzimet, ju ia keni

kthi prapë dhe i keni thënë: ne mendojmë që këto shpenzime janë të koduara drejt sepse janë shpenzime për qytetaret, duhet me gjet një mundësi që me u rekomandu edhe ky implementim sepse nuk është përgjigjja e duhur mendoj, ndërsa tek çështjet tjera që janë vërejtur disa dobësi apo mangësi tek kontrolli menaxhorial mendoj se këtu mundemi me rrit efikasitetin për shkak se i kemi resurset dhe i kemi mundësit që me qenë sa më efikas në punë që këto procedura me u përfillë në mënyrë ma të mirë të mundshme që herën e ardhshme mos me pas rekomandime dhe ne nuk guxojmë më bë tolerim.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës:
8.Propozim Vendimin për Financimin e Projektit HANDIKOS-Drenas.

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

Për votuan 22 anëtar,
Kundër 00 anëtar
Abstenim 00 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës:
9. Propozim vendim për themelimin e komisionit komunal të aksionareve të NPL – Stacioni i Autobuseve SH.A Glllogoc. (i plotësuar.)

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- këtë propozim vendim na ka kthi MAPL-ja që nuk e kemi bërë mirë preambulën, dhe vetëm do ta ndërrojmë preambulën dhe komisionin.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- komision nga kuvendi është: Bujar Dervishi dhe Petrit Gashi ndërsa nga ekzekutivi –Ruzhdi Lestrani ndërsa nga Stacioni i Autobusëve Remzi Dervishi dhe Heteme Rrusta


Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:
Për votuan 22 anëtar
Kundër 00 anëtar
Abstenim 00 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës:
10.Të ndryshme.

Pasi nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi konsideroj mbledhjen e mbyllur.
Mbledhja përfundoi në ora: 12:55 min.

Procesmbajtëse:

Zahrie Podrimqaku-Subashi
Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Labinot Halilaj